



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 27 Janar 2022

Nr: 6

V E N D I M

P Ë R

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 11, DATË 25.03.2021, TË KOMISIONIT RREGULLATOR, “PËR MËNYRËN E NGRITJES, ORGANIZIMIT, FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT DHE ZHVILLIMIT TË ZGJEDHJEVE NË QENDRËN E VOTIMIT”

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronjat “a” e “b”, nenit 22, pika 3, nenit 36 e vijues, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

1. Titulli i lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet vendimit nr. 11, datë 25.03.2021, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e ngritjes, organizimit, funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në Qendrën e Votimit”, ndryshohet si më poshtë vijon:
“Rregullat e përdorimit dhe specifikimet teknike të kamerave regjistruese në Qendrat e Votimit”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO	Kryetar
Arens ÇELA	Anëtar
Dritan ÇAKA	Anëtar
Helga VUKAJ	Anëtar
Muharrem ÇAKAJ	Anëtar

